



Rrokum TV
Migjen KELMENDI
Drejtor
Prishtinë

Rasti Nr. 2019/80
Ref:1910/1235/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2019/80- Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Rrokum TV (“Palë Përgjegjëse”)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr.03/L-073, përmes të cilit përcaktohet sjellja e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin e VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhje.
2. KPM me datë 19 shtator 2019 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073, me qëllim që t'i ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore dhe heshtjes zgjedhore.
3. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse prej datës 25 shtator deri me 6 tetor 2019, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse dhe bazuar në Raportin e monitorimit të datës 9 tetor 2019, ka gjetur se Pala Përgjegjëse gjatë raportimit të fushatës zgjedhore ka favorizuar subjektin politik PDK gjatë gjithë fushatës zgjedhore në përqindje prej 64.84 % në krahasim me subjektet tjera politike, duke vepruar në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073.

Analiza Ligjore

4. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala Përgjegjëse ka dështuar të veproj në pajtim me nenin 48 të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073.

Neni 48 i Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073, përcakton se:

“Të gjitha mediat sigurojnë se të gjitha subjektet politike të certifikuara përfaqësohen në mënyrë të drejtë dhe të paanshme në emisionet gjatë fushatës së zgjedhjeve, dhe të gjitha mediat transmetuese u sigurojnë të gjitha subjekteve politike të certifikuara qasje të drejtë dhe të paanshme në programet me diskutime politike dhe debate.”

5. Komisioni gjatë monitorimit ka konstatuar se Pala Përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore ka bërë shkelje të nenit 48 të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073, duke favorizuar një subjekt të caktuar politik për faktin se të gjitha mediat duhet të sigurojnë që subjektet politike duhet të përfaqësohen në mënyrë të drejtë dhe të paanshme gjatë fushatës zgjedhore.
6. Komisioni duke u bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 48, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073.

Vendim

7. Pala Përgjegjëse sanksionohet me gjobë në shumë prej 2,000 (dymijë) euro në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 48, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073.

E drejta për Ankesë

8. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
9. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Muja FERATI
Kryetar



18.10.2019
Datë